



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300200/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave, për përmirësimin e shërbimeve të ofruara për fëmijët në shtëpinë e foshnjës 0-5 vjeç "Hannah dhe Rozafa", Tiranë.

**BASHKISË TIRANË**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL  
SHTETËROR**

**TIRANË**

Të nderuar,

Në përmbushje të mandatit që institucioni i Avokatit të Popullit ka për mbrojtjen, garantimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijës<sup>1</sup>, po ju drejtohem nëpërmjet këtij rekomandimi, për të ndarë me Ju konstatimet e gjetjet e inspektimit, por edhe problematikat që duhen vlerësuar për t'u përmirësuar në kuadrin e detyrave dhe kompetencave ligjore të veprimtarisë suaj shtetërore.

Në zbatim të Urdhrit nr.24, datë 7.02.2023 të Avokatit të Popullit, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve/institucioni i Avokatit të Popullit realizoi inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Foshnjës "Hannah

<sup>1</sup> Bazuar në nenin 1 të Konventës e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989), me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

dhe Rozafa”, Tiranë<sup>2</sup>. Shërbimet në këtë qendër rezidenciale janë ato të strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohen kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit<sup>3</sup>. Avokati i Popullit pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare.

**Objektivi i inspektimit:** Respektimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, dhe ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

**Metodologjia** e përdorur nga grupi i inspektimit, konsistoi si vijon:

- **së pari**, u zhvilluan biseda paraprake me drejtuesin dhe përgjegjësen e sektorit social të këtij institucioni të përkujdesit publik rezidencial, informacion i cili u hodh në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- **së dyti**, u mblodhën dhe u administruan dokumentat e kërkuara nga grupi inspektues.
- **së treti**, u monitoruan dhe u inspektuan në vend kushtet materiale në të cilat jetojnë fëmijët, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, dushet, pajisjet e hotelerisë, veshmbathjet, ushqimi, kuzhina, lavanteria, higjiena, lagështira, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme, etj.

Grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të ligjit organik të AP-së, kreu bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, të cilëve iu adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit në Shtëpinë e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa”.

### **Administrimi, funksionimi dhe organizimi i Shtëpisë së Foshnjës “Hannah dhe Rozafa”, Tiranë<sup>4</sup>”**

Institucioni rezidencial i përkujdesit social për fëmijë 0-5 vjeç<sup>5</sup> “Hannah dhe Rozafa”, strehon e jep përkujdese për foshnje të braktisura që në lindje, fëmijë

---

<sup>2</sup> Vizita monitoruese është realizuar me datën 16.02.2023 në mjediset e shtëpisë së fëmijës “Hannah dhe Rozafa”

<sup>3</sup> Neni 21, i ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>4</sup> Shtëpia e foshnjës “Hannah dhe Rozafa”, Tiranë është qendër kujdesi shoqëror e licensuar për të ofruar shërbim të përkujdesit rezidencial (LN-0853-2021, Kodi X.1.B., lëshuar më datë 08.02.2010, pa afat).

<sup>5</sup> VKM-ja nr. 106, datë 15.2.2017, “Për një ndryshim në VKM-në nr. 425, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike

jetim të kësaj grupmoshe, si dhe nga fëmijë të ardhur nga familje me probleme sociale<sup>6</sup> dhe në pamundësi për t'u kujdesur për fëmijën e tyre. Ky institucion ofron shërbimin për një kapacitet prej 50 fëmijësh<sup>7</sup>.

Shërbimet që ofrohen nga institucioni janë ato të **mirërritjes** së fëmijëve, duke garantuar ushqim, siguri jetese, veshmbathje, **përkujdes shëndetësor**, si dhe **shërbime psiko-sociale** (aktivitete argëtuese, informuese etj.).

Qëllimi i këtij institucioni është ofrimi i shërbimeve rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë duke siguruar mirëqënien fizike dhe emocionale, mbrojtje dhe siguri, zhvillim dhe integrim në jetën shoqërore, si dhe garantimin e një strehe të ngrohtë familjare në respektimin e të drejtave dhe në interesin më të lartë të fëmijës. Aktualisht në këtë institucion marrin shërbim 26 fëmijë (16 djem edhe 10 vajza) të ndarë në dy godina konkretisht, 12 fëmijë në godinën "Rozafa", e cila ka një ambjent të rregullt, me materiale hotelerie të reja dhe të pastra si dhe është pajisur me dollape të cilët janë në gjendje të mirë. Ndërsa në godinën "Hannah" akomodohen 14 fëmijë. Ambjenti i përbashkët i kësaj godine është i shtruar me parket, tapet dhe me shumëllojshmëri lodrash për grupmoshat e fëmijëve të akomoduar aty. Për sa i takon moshës së fëmijëve të vendosur në këtë institucion rezidencial rezulton që:

- 17 fëmijë i përkasin moshës 0-3 vjeç;
- 4 fëmijë i përkasin moshës 3-5 vjeç;
- 5 fëmijë janë mbi 5 vjeç.

Institucioni ishte i mirëndriçuar, i lyer e i monitoruar me kamera sigurie. Në institucion kishte fikëse zjarri dhe bashkalidhur me to edhe procedurat e përdorimit të tyre. Higjena e dhomave të fëmijëve si dhe e vetë fëmijëve ishte në nivelin e duhur të pastërtisë dhe mirëmbajtjes. Çdo fëmijë kishte të personalizuar veshjet, peshqirat, furçat dhe pastat e dhëmbëve. Në mjediset e qendrës ishin të afishuara informacione të ndryshme, si Deklarata, Rregullore, Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Institucionet Rezidenciale, të drejtat e fëmijëve, kriteret e përfitimit të shërbimit,

---

dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", të ndryshuar, në pikën 1 të vendimit parashikon ndryshimin e moshës së pranimit të fëmijëve në këto institucione, sipas tipologjive të caktuara të shërbimit, konkretisht: 0–5 vjeç; 6–15 vjeç dhe 16–18 vjeç.

<sup>6</sup> Ligjin Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 18/2017 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"; VKM nr. 658 datë 17.10.2005 "Për standartet e Shërbimeve Shoqërore"; VKM nr. 659 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale"; VKM nr. 518 datë 04.09.2018, "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim si dhe masën për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit"; Vkm nr. 106 datë 15.02.2017 "Për kriteret e vendosjes ne institucione rezidenciale të Perkujudesit Shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim" - i ndryshuar.

dokumentimi i aktiviteteve, oraret, informacione për ankimim, denoncim dhe ndihmën në raste emergjence etj. Gjithashtu, në hyrje të godinës janë të afishuara numrat e kontaktit të institucioneve si, të policisë, zjarrfikses dhe urgjencës së spitalit. Në hollin kryesor të institucionit ishte i vendosur libri i lëvizjeve për vizitorët dhe për punonjësit e institucionit. Institucioni është i vendosur në një zonë të qetë, me ajër të pastër, në një mjedis relaksues e të gjelbëruar dhe është i pajisur me lodra për fëmijë.

Nga monitorimi i mjediseve të institucionit u konstatua se, në katin e parë janë vendosur dy mjedise kuzhine të cilat janë të pajisura me të gjitha pajisjet frigoriferike të nevojshme për funksionimin normal të përgatitjes së ushqimit, pastrimin e pjatave, etj. Ushqimi ishte i organizuar me menu, në përputhje me grupmoshat e tyre, dhe shërbehej disa herë gjatë ditës, sipas orareve të përcaktuara, duke specifikuar gramaturën (për gjithsecilin në varësi të moshës) dhe nevojat individuale të përcaktuara nga mjekja e institucionit<sup>8</sup>. Kampionet ushqimore gjendeshin të ruajtura dhe të vendosura në frigorifer, por pa pasur të shkruar datën përkatëse.

### ***Organigrama e shtëpisë së foshnjës “Hannah dhe Rozafa”***

Organika e institucionit<sup>9</sup> përbëhet nga drejtuesi i qendrës dhe 38 punonjës të ndarë në: 2 përgjegjës sektori (përgjegjës sektori i administratës dhe përgjegjës sektori social), 3 punonjës specialistë, 1 punonjës magazinier, 1 punonjës psikolog, 1 punonjës edukatore, 1 punonjës kryekujdestare, 23 punonjës kujdestarë, 1 punonjës kuzhinier, 3 punonjës sanitarë, 1 punonjës shofer, 1 punonjës mirëmbajtës<sup>10</sup>. Puna e stafit të institucionit është e organizuar sipas grafikut të turneve që është në përputhje me prezencën e punonjësve. Janë të organizuara 3 turne, 8-orarshe sipas këtyre harqeve kohore; 06.30 deri më 14.30; 14.30 deri më 22.30 dhe 22.30 deri më 06.30. Në momentin e dorëzimit të turnit çdo kujdestare vendos shënimet/proces-verbalet mbi ecurinë e punës me fëmijët gjatë kryerjes së turnit, si dhe konstatimet mbi çështjet shëndetësore.

Për sa i përket shërbimit mjekësor, institucioni ka mjek pediatër, i cili është *part-time* dhe ofrohet nga marrëveshja që institucioni ka me Fondacionin Amerikan “Shërbimet Sociale Bethany”. Për çdo fëmijë është e hapur kartela shëndetësore dhe librezja e vaksinimit. Nga kontrolli i kartelave rezulton se ka shënime periodike të vizitave, kontrolleve të përgjithshme shëndetësore, si dhe mjekimet e vaksinat janë ndjekur dhe realizuar në kohë. Mjeku i institucionit

<sup>8</sup> Lista e ushqimit, për çdo grupmoshë dhe me emra individual fëmijësh, ishte e afishuar në mur e miratuar nga drejtori i qendrës, mjeku, përgjegjësi i sektorit social, kuzhinjer dhe kryekujdestaria.

<sup>9</sup> Miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.88, datë 25.10.2011.

<sup>10</sup> Si evidence shërbeu numri i të punësuarëve nga fondi i pagave për 3-mujorin e IV-të të vitit 2022.

ka një regjistër që regjistron të gjitha vizitat e kryera me secilin fëmijë. Mjeku dhe kryekujdestarja kanë një fletore të veçantë ku shënohen ilacet dhe, aty vendosen shënime për marrjen e ilaceve për fëmijët, oraret e marrjes së ilaceve si dhe sasia që duhet të merret. Në rastet kur fëmija është me temperaturë apo ka pasur dicka specifike shënohet emri i tij, ilaci dhe sasia që duhet të marrë, ndërsa në rastet kur ka fëmijë të cilët kanë nevoja të veçanta apo probleme shëndetësore që në lindje ofrohet shërbim edhe më i specializuar.

Gjatë vitit 2022 në këtë institucion janë akomoduar 16 fëmijë (gati 1/3 e kapacitetit), nga të cilët 5 fëmijë të ardhur me masë mbrojtje. Fëmijëve u janë bërë ekzaminimet klinike biokimike dhe mikrobiologjike (HIV-AIDS, HEPATIT etj.) dhe janë mbajtur në dhomen e izolimit sipas protokollit të rasteve emergjente deri në marrjen e përgjigjes së analizave. Të gjithë fëmijët që kanë ardhur të rinj në institucion, janë pajisur me kartela mjekësore dhe janë planifikuar për vaksinim, sipas planit vjetor të vaksinimit. Është bërë dezinfektimi dhe higjienizimi me bazë klori dhe alkooli i të gjithë ambienteve dhe orendive të institucionit. Janë kryer të gjitha procedurat rutinë për regjistrimin e të dhënave të rritjes, si peshja, gjatësia etj., të cilat janë shënuar në kartelën mjekësore të fëmijëve.

Fëmijët me probleme kronike janë ndjekur në vazhdimësi nga mjeku i institucionit dhe mjeku specialist në QSUT, sipas specifikave me konsulta përkatëse të planifikuara<sup>11</sup>.

Gjithashtu, ndiqen në mënyrë dinamike nga mjeku i institucionit edhe fëmijët që frekuentojnë kopështin për nevoja dhe problematika që mund të shfaqin. Në bashkëpunim me Poliklinikën Qëndrore Tiranë kryhen analizat e përgjithshme biokimike për të gjithë fëmijët në institucion, çdo 6 muaj dhe sa herë të rekomandohet e nevojshme nga ana e mjekut të institucionit.

Grupi monitorues i AP-së asistoi në rutinën ditore të punës së kujdestareve dhe konstatoi se gjatë ndërrimit të pelenave apo veshmbathjeve të fëmijëve, atyre u ofrohej gjithë kujdesi dhe shërbimi i nevojshëm. Dhoma ku kryhej procesi i ndërrimit ishte në temperaturën e duhur dhe e pajisur me mjetet e nevojshme si, tavolinë e ndërrimit të rrobave dhe pelenave, çezmë me ujë të rrjedhshëm

---

<sup>11</sup> Gjatë vitit 2022 në pavionin e pediatriisë në QSUT kanë qenë të shtruar për të marrë mjekim të specializuar fëmijët: H.V., L.B., A.B., M.R. Kanë kryer vizite te mjeku neuropediatër fëmijët: A.M., E. A., H.V. Kan bërë vizitë te mjeku okulist fëmija E.M. Ka bërë vizitë te mjeku nefropediatër fëmija M. GJ. Kanë bërë vizitë te mjeku kardiolog fëmijët: M.Q dhe L.B. Ka bërë vizitë në QKMZHF fëmija D.D. Ka marë shërbime në pavionin e ORL për probleme stomatologjike fëmija M.R. Kan bërë vizitë te mjeku Dermatolog D.I. Kanë kryer vizite te mjeku Ortoped E.D, H.V. Fëmija A.M dhe H. V. janë ndjekur me seança fizioterapie. Kanë marë shërbime stomatologjike fëmijët M.GJ., R.F., M.R. Në bashkëpunim me QKMZHF Kombinat është bërë e mundur ndjekja e terapisë së zhvillimit dhe fizioterapi për fëmijën A.M.

dhe të ngrohtë, si dhe sasi të mjaftueshme materialesh konsumi të nevojshëm për fëmijët (krem, pampers, shampoo etj.).

Problematicë e evidentuar nga stafi monitorues dhe i pohuar nga drejtuesi i qendrës ishte mungesa e një psikologu **me kohë të plotë**. Psikologu në këtë institucion ofron shërbim përgjatë një kohe 4-orarshe. Prania e një psikologu dhe mbështetja psiko-sociale është e rëndësishme t'u ofrohet fëmijëve individualisht ose në grup, pasi synon inkurajimin, rehabilitimin, zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të fëmijëve/përfituesve. Kjo mbështetje psiko-sociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara, gjithmonë kur ajo vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit<sup>12</sup>.

### ***Dinamika e lëvizjes së përfituesve në institucionin “Hannah dhe Rozafa”***

Gjatë vitit 2022 në këtë institucion janë asistuar një numër prej 47 fëmijësh, nga të cilët 16 fëmijë janë hyrje të reja në institucion ndërsa 31 janë ekzistues që prej vitit 2021.

<b>Hyrje në institucion në vitin 2022</b>	<b>Nr.i fëmijëve</b>
Raste emergjente /Me vendim	4
Raste të ardhura nga materniteti	11
Raste me vendim gjykate	1 (me masë mbrojtje nga bashkia)
Rast i ardhur si transferim nga institucion tjetër	0
<b>Dalje nga institucioni</b>	17 (11 birësime, 4 kthime në familje dhe 2 transferime)

Referuar statistikave dhe dinamikave të lëvizjes së fëmijëve që nga viti 2015 e deri në vitin 2022 rezulton që:

- **Fëmijë të asistuar në 2015:** 48 fëmijë nga të cilët: 29 hyrje dhe 28 të mbartur. Birësuar 18 dhe kthim në familje 1 rast.
- **Fëmijë të asistuar në 2016:** 48 fëmijë nga të cilët 20 hyrje dhe 28 mbartje nga 2015. Birësime 13, kthim në familje biologjike 5 dhe raste emergjente 4;

<sup>12</sup> Neni 13, i ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

- **Fëmijë të asistuar në 2017:** 54 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 24 dhe 30 të mbartur nga 2016. Raste emergjente të pritura dhe trajtuara 12 fëmijë, 1 fëmijë për riatdhesim.
- **Fëmijë të asistuar në 2018:** 56 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 25 dhe 31 të mbartur nga 2017. Birësime 9, rikthim në familje biologjike 9, rikthim pranë familjes me lidhje gjaku 1 fëmijë (rast emergjent 72 orësh), 2 raste të trajtuara në emergjencë; raste emergjente të pritura dhe trajtuara 8 fëmijë, transferim për shkak të moshës 1.
- **Fëmijë të asistuar në 2019:** 47 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 16 dhe 31 të mbartur nga 2018. Birësime 9, rikthim në familje biologjike 2, raste emergjente të pritura dhe trajtuara me masë mbrojtje nga Bashkia 2 fëmijë, transferim për shkak të moshës 3 fëmijë, vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku 1 fëmijë.
- **Fëmijë të asistuar në 2020:** 45 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 13 dhe 32 të mbartur nga 2019. Birësime 8, rikthim në familje biologjike 1, raste emergjente të pritura dhe trajtuara me masë mbrojtje nga Bashkia 2 fëmijë, transferim për shkak të moshës 2 fëmijë, vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku 0 fëmijë.
- **Fëmijë të asistuar në 2021:** 45 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 11 dhe 34 të mbartur nga 2020. Birësime 9, rikthim në familje biologjike 2, raste emergjente të pritura dhe trajtuara me masë mbrojtje nga Bashkia 2 fëmijë, transferim për shkak të moshës 2 fëmijë, vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku 1 fëmijë.
- **Fëmijë të asistuar në 2022:** 47 fëmijë nga të cilët hyrje të reja 16 dhe 31 të mbartur nga 2021. Birësime 11, rikthim në familje biologjike 4, raste emergjente të pritura dhe trajtuara me masë mbrojtje nga Bashkia 5 fëmijë, transferim për shkak të moshës 2 fëmijë.

Nga vlerësimi i referimit të rasteve përgjatë vitit 2022, konstatojmë se 35 përfitues janë akomoduar në institucion si raste emergjente nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, ndërsa 2 përfitues janë të akomoduar si fëmijë, jetimë biologjik. Nga analizimi i shifrave të mësipërme vihet re një numër i vogël i numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga institucioni i përkujdesit shoqëror (IPSH-ja). Ky numër i vogël vjen si rrjedhojë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, ku gjykatat marrin një kohë të konsiderueshme për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente por, njëkohësisht edhe për shkak të punës së pamjaftueshme nga strukturat vendore për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve. Shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë ato me lidhje gjaku, ndërsa numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku është krejt i papërfillshëm. Asnjë Njësi e

Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nuk ka hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku<sup>13</sup>.

Është mjaft i rëndësishëm ofrimi i shërbimeve alternative të reja parandaluese dhe riintegruese të fëmijës, në një mjedis të përshtatshëm, në familjen biologjike apo kujdestare të përkohshme, duke realizuar plotësisht potencialin e tij. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të përkujdesjes sociale të integruar, funksional dhe gjithëpërfshirës.

Koha e qëndrimit të fëmijëve në këtë institucion cilësohet e gjatë, pasi varion nga minimumi 1 vit e deri në maksimumin 5 vjet. Ky tregues është shqetësues, pasi nuk është në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, që nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të<sup>14</sup>.

Fëmijët e sistemuar në këtë institucion ndodhen aty për arsye të situatës së vështirë ekonomike dhe mungesës së mbështetjes së duhur nga familjet e tyre, si rezultat i problemeve sociale, të cilat sjellin uljen e përgjegjësisë prindërore për kujdesin ndaj fëmijëve. Pranimi dhe vendosja e fëmijës në institucionet e përkujdesit rezidencial shoqëror, që kthehet në kujdes institucional afatgjatë është parë si zgjidhja e vetme që ofrojnë organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor<sup>15</sup>.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve përcakton se “...fëmija, për zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë të lumtur, me dashuri dhe mirëkuptim”.

---

<sup>13</sup> <https://www.unicef.org/albania/media/4391/file/AKDF%202021-2026%20ALB.pdf>, parag.1, faqe 26.

<sup>14</sup> Pika 3, e nenit 6 të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

<sup>15</sup> Ligji 18/2017, në nenin 31 mbi “Përkujdesja alternative” parasheh se: “1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për **shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative**. Në zbatimin e kësaj mase i jepet **përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar**, sipas interesit më të lartë të fëmijës. 2. Përkujdesja alternative mund të jetë: a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës; b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën; c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe. 3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji. 4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes”.



Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, (neni 56) përcakton dhënien e masës emergjente të mbrojtjes për rastet e fëmijës në rrezik të menjëhershëm dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet vendosjes në një strehim të sigurt, siç mund të jetë vendosja e fëmijës në një strehëz rezidenciale, kur nuk janë të mundura alternativat e tjera si familja biologjike apo kujdestare (pika “c” e nenit 57). Legjislacioni shqiptar i ka integruar parimet kyçe të dokumenteve ndërkombëtare që mbështesin kujdestarinë e fëmijës pa kujdes prindëror.

Institucioni i Avokatit të Popullit e vlerëson si shqetësues problemin e institucionalizimit të fëmijëve, të cilët në fakt në institucionet e përkujdesit social rezidencial marrin vetëm shërbimet jetike bazë. Qëndrimi afatgjatë i fëmijëve në institucion, kalimi i fëmijëve nga një institucion në institucion tjetër dihet se rezulton në pasoja negative për zhvillimin psiko-social në tyre. Pavarësisht përpjekjeve të institucionit “Hannah dhe Rozafa”, fakti që fëmijët vijnë me qëndrim afatgjatë, tregon mungesë të fuqizimit e përmirësimit të situatës dhe kushteve social-ekonomike për familjet biologjike të këtyre fëmijëve. Mosveprimi nga ana e organeve të administratës publike për ngritjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fuqizimin e familjeve biologjike dhe evidentimin e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse ka ndikuar negativisht sa i përket kryerjes së procesit të deinstitutionalizimit dhe largimit të fëmijëve nga institucioni. Nga vlerësimi i informacionit të gjeneruar, kohëqëndrimi i gjatë i fëmijëve në këtë institucion është problematik, dhe mund të konsiderohet si neglizhim<sup>16</sup>.

Institutionalizimi, si hap i fundit i fëmijëve<sup>17</sup>, sjell pasoja të rënda në zhvillimin mendor, fizik, psikologjik dhe social të tyre. Qëndrimi për një kohë të gjatë në institucione shfaqet me sjellje provokuese, si agresivitet, vonesa në zhvillimin psikologjik e emocional të fëmijës dhe të aftësive për integrim social. Kuptohet që institucionet nuk arrijnë të sigurojnë kujdesin dhe vëmendjen individuale ndaj çdo fëmije, si dhe dashurinë që fëmija e merr në familje. Vlerësimi i nevojave dëshmon qartë që fëmijët, me dhe pa aftësi të kufizuara, janë veçanërisht të cenueshëm ndaj efekteve të dëmshme të institutionalizimit, sepse institucionet nuk ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e tyre psikologjik dhe emocional. Institucionet e kujdesit rezidencial përqendrohen kryesisht në kujdesin fizik sesa në shërbimet individuale të zhvillimit, si dhe kanë prirjen të ofrojnë programe dhe shërbime

---

<sup>16</sup> Në zbatim të pikës 10, të nenit 3 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” “Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës

<sup>17</sup>Neni 267, i ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes” ku përcakton një kusht të qartë duke konsideruar institutionalizimin e fëmijës si një mundësi të fundit.

të krijuara për t'u shërbyer fëmijëve jetimë, sesa atyre që janë abuzuar, shfrytëzuar, lënë pas dore ose dëmtuar<sup>18</sup>.

Deinstitucionalizimi<sup>19</sup> nuk duhet kuptuar thjesht si mbyllja e institucioneve për fëmijët, por si procesi i transformimit gjithëpërfshirës të strukturave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Ai përfshin marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse për të siguruar zgjidhje të nevojshme dhe të përshtatshme të kujdesit alternativ për fëmijët që nuk mund të qëndrojnë me familjet e tyre biologjike. Nëse vendosja në kujdesin alternativ është qartësisht në interesin më të mirë të fëmijës, duhet të ketë disa opsione/mundësi në varësi të situatës, nevojave dhe dëshirave të fëmijës, në përputhje me aftësinë e fëmijës për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Këto mund të përfshijnë kujdes farefisnor (kujdes familjar brenda familjes së zgjeruar të fëmijës), përkujdesje sociale, vendosje në strukturën e familjes kujdestare pa lidhje gjaku, birësim, etj. Përpara mbylljes së institucioneve, duhet të krijohen një sërë shërbimesh me cilësi të lartë dhe zgjidhje të përkujdesit alternativ. Aty ku është në interesin më të mirë të fëmijës, duhet të bëhen përpjekje për të ribashkuar fëmijën me familjen e tij/saj biologjike dhe familja duhet të jetë në gjendje të aksesojë shërbimet përkatëse për ta ndihmuar fëmijën të përshtatet me jetën familjare<sup>20</sup>.

Plani kombëtar i deinstitucionalizimit 2020-2022 shënoi në vetvete fillimin e mirë të punës për të eliminuar institucionalizimin e fëmijëve në vendin tonë. Ndërtimi i një sistemi të integruar të shërbimeve sociale, multifunksionale e në përputhje me standardet bashkëkohore synon ri-integrimin e fëmijëve në jetën normale për të siguruar një mjedis natyror për rritjen, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës siç është familja. Tashmë që afati i përcaktuar në Planin Kombëtar të Deinstitucionalizimit 2020-2022<sup>21</sup> ka përfunduar, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet kryer një analizë e rezultateve, arritjeve dhe mangësive që e shoqëruan këtë plan kombëtar, gjë që do të passillte edhe hapat e mëtejshëm që do të hidhen në interesin më të lartë të fëmijëve, që nuk përfituan nga deinstitucionalizimi.

Në Udhëzuesit e OKB-së për Kujdesin Alternativ për Fëmijët përcaktohet se: “Pika 4. Çdo fëmijë dhe i ri duhet të jetojë në një mjedis mbështetës, mbrojtës dhe përkujdesës që promovon potencialin e tij/saj të plotë. Fëmijët në përkujdesje të pamjaftueshme ose pa përkujdesje prindërore **përballen me**

---

<sup>18</sup> Prag.3, faqe 15 i Vendimit nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021–2026”.

<sup>19</sup> Në shtator 2020 u miratua Plani Kombëtar i Deinstitucionalizimit 2020–2022, i cili mendohet të shtyhet deri në vitin 2024 për të mundësuar që çdo fëmijë në institucionet e përkujdesjet, apo në rrezik institucionalizimi do të mbështetet me shërbime të reja alternative, në familje kujdestare apo shërbime të specializuara.

<sup>20</sup> <https://www.eurochild.org/uploads/2021/02/Opening-Doors-QA.pdf>

<sup>21</sup> Vendimi nr.706, datë 9.09.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit, 2020-2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”

**rrezikun e mohimit të një mjedisi të tillë mbështetës.** Pika 5. Kur familja e fëmijës, megjithë mbështetjen e ofruar, nuk është në gjendje që të sigurojë përkujdesje të mjaftueshme për fëmijën, e braktis, ose heq dorë prej tij, atëherë shteti është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe sigurimin e përkujdesjes së duhur alternative, me ose nëpërmjet autoriteteve lokale kompetente dhe organizatave të shoqërisë civile të autorizuara sipas rregullave”<sup>22</sup>.

Autoritetet përgjegjëse duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të fuqizuar familjen për rritjen dhe mirërritjen e fëmijëve të tyre ose ofrimin e mundësive të kujdesit alternativ. Institucioni duhet të jetë alternativa e fundit për qëndrimin dhe rritjen e tyre. Ndaj theksojmë rëndësinë e fuqizimit të një sistemi të integruar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të zbatimit të planeve konkrete për ngritjen, financimin dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen.

Kjo në frymën e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, legjislacionit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, si dhe atij të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Ky i fundit, ndër të tjera, garanton të drejtën e fëmijëve për t’ju ofruar shërbime mbështetëse, në rastet kur ata mbeten jashtë përkujdesit të familjes për faktorë natyralë, socialë apo ligjorë. Kujdestaria është një ndër alternativat ligjore për fëmijët për t’u rritur pranë një mjedisi familjar, nën kujdestarinë e një kujdestari apo familjeje kujdestare dhe institucioni publik rezidencial duhet të jetë alternativa e fundit.

Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës si nga institucionet shtetërore apo ato private, të përkrahjes shoqërore, ashtu dhe nga gjykatat dhe organet e administratës shtetërore. Bashkia e Tiranës, duhet të ndërmarrë hapat konkretë në përmbushje të qëllimit për fuqizimin e familjeve të fëmijëve të vendosur në institucionin rezidencial “Hannah dhe Rozafa” dhe për evidentimin e familjeve kujdestare, sipas VKM nr. 149/2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”.

Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore. “Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për

---

<sup>22</sup> <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/5416.pdf/>

ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj<sup>23</sup>. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Familjes”<sup>24</sup>. Neni 31 i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” që rregullon përkujdesjen alternative, parashikon se: “1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. **Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar**, sipas interesit më të lartë të fëmijës”.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ka si qëllim ndër të tjera “parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit”. Më tej, në këtë ligj, në nenin 5 të tij, specifikohet se çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.

“Sistemi i integruar i mbrojtjes” është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësi dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës<sup>25</sup>.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut. Në themel të tyre janë parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, detyrimet dhe

<sup>23</sup> Neni 30, pika 1, i ligjit nr.18/2017

<sup>24</sup> Neni 30 i ligjit 18/2017

<sup>25</sup> Neni 3, pika 16 e Ligjit nr.18/2017

angazhimet e përcaktuara në Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Në bazë të tyre, fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Ndaj, respektimi dhe vlerësimi i dinjitetit të fëmijëve, në përgjithësi, veçanërisht i kategorive të fëmijëve jetimë, janë një sfidë e madhe që lidhet pazgjidhshmërisht me garantimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në një shoqëri që aspirojnë vendosjen dhe konsolidimin e vlerave demokratike. Udhërrëfytes të pazëvendësueshëm në këtë përpjekje jetike globale për shoqëritë demokratike, janë parimet e interesit më të lartë të fëmijës, të mosdiskriminimit, të pjesëmarrjes, mbijetesës dhe zhvillimit të tij.

Ndaj ky rekomandim e ka pikënisjen në nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtet-shoqëri, për të siguruar kushtet që fëmijët të nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë të kenë mundësi e mbështetje për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm. Shteti duhet të prioritetizojë rolin parësor të familjes në mbrojtjen e fëmijëve dhe të sigurojë kujdes dhe mbështetje në mënyrë që çdo vendim të merret mbi bazën e interesave më të larta të fëmijës<sup>26</sup>. Zbatimi i Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”<sup>27</sup> është thelbësor për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjitha të drejtave nga fëmijët.

Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Fëmijët pa kujdes prindëror përbëjnë një nga grupet më të lëna pas dore, shpesh me shërbime bazë apo mundësi për zhvillim të munguara<sup>28</sup>.

Institucioni ynë ka ndërgjegjësuar ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijës, në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë, pa dallim, të gëzojnë të drejtat e tyre. Në këtë frymë, këto të drejta themelore dhe të patjetërsueshme shkojnë paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivat 3 dhe 10.2), të cilat theksojnë rëndësinë e sigurimit të një jetese të shëndetshme dhe promovimit të mirëqënies për të gjithë në të gjitha moshat si dhe ulja e pabarazisë duke fuqizuar dhe promovuar përfshirjen sociale dhe ekonomike të të gjithëve,

<sup>26</sup> Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 26.7.2019 “Status of the Convention of the Rights of the Child-Report of the Secretary General”, 68 session.

<sup>27</sup> Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015.

<sup>28</sup> Me 18.12.2019 Asambleja e Përgjithshme e OKB ka miratuar Rezolutën për të Drejtat e Fëmijës me fokus kryesor fëmijët pa kujdes prindëror. Rezoluta i bën thirrje Shteteve që të zbatojnë Udhëzuesit e Kujdesit Alternativ për fëmijët dhe i kërkon Shteteve të forcojnë sistemin e mbrojtjes dhe mirëqënies sociale për fëmijët, si dhe përmirësimin e reformave të përkujdesit. A/RES/74/395 General Assembly resolution “Rights of the Child”.

pavarsisht nga mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, raca, etnia, origjina, feja apo statusi ekonomik ose ndonjë status tjetër. Avokati i Popullit është një nga aktorët e angazhuar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të këtyre të drejtave.

Në këtë kuptim, në frymën e legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDON :**

- Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë për fuqizimin e familjeve biologjike dhe të shërbimit të kujdestarisë<sup>29</sup> për fëmijët në nevojë, duke përfshirë shtimin e ndërgjegjësimit të publikut për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë (me qëllim rritjen e numrit të familjeve që do të ofrojnë shërbimin e kujdestarisë), si dhe për ndikimet negative që ka në zhvillimin e fëmijës vendosja në institucionet e përkujdesit social rezidencial.
- Rritjen e bashkëpunimit të Bashkisë Tiranë me organizatat e shoqërisë civile, për të krijuar programe mbështetëse për prindërit dhe kujdestarët, të cilat synojnë krijimin dhe prezantimin e praktikave të mira për mirërritjen e fëmijëve, bazuar në njohjen e të drejtave të fëmijëve, zhvillimin e tyre dhe teknikat disiplinore pozitive dhe për mbështetjen e familjeve për t’u siguruar fëmijëve kujdes<sup>30</sup> dhe një mjedis të sigurtë.
- Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë për të ofruar tipologji të reja të shërbimeve sociale me fokus fëmijët, për të bërë të mundur progresin e familjeve që mbartin probleme ekonomike ndër vite me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve, parandalimin e neglizhimit të tyre, si dhe shmangien e institucionalizimit për një kohë të gjatë të tyre.

---

<sup>29</sup>VKM nr. 149, datë 13.03.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare” .

<sup>30</sup> Bazuar dhe në përcaktimet e ligjit nr. 126/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

- Marrjen e masave për bashkërendimin efektiv midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Tiranë për koordinimin e shërbimeve sociale për fëmijët sipas detyrimeve përkatëse ligjore<sup>31</sup>.
- Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin e një psikologu me kohë të plotë në institucionin rezidencial shtëpia e foshnjës 0-5 vjeç “Hannah dhe Rozafa”.
- Marrjen e masave nga shtëpia e foshnjës 0-5 vjeç “Hannah dhe Rozafa” për vendosjen e datës përkatëse në provizat/kampionet ushqimore ditore.
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për realizimin e trajnimeve për rritjen e njohurive të stafit të institucionit me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore, konform standardeve si dhe ofrimin e programeve dhe aktiviteteve social-kulturore në komunitet me/për fëmijët.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi e, në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj tij.

**Me respekt,**

**K O M I S I O N E R**

**Olta ALIAJ**

---

<sup>31</sup> Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

